



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 25.08.2021,
duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci, Blerand Stavileci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Egzon Azemi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florim Krasniqi, zyrtar nga Urbanizmi dhe Leutrim Retkoceri, asamblist.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi informoi se ka ardhur një propozim nga UNOPS-i, Sherafedin Mustafa, pasi që ata janë bartës të projektit, zbatues të projektit për SHFMN në Bregun e Diellit, që do të bëhet në atë zonë, andaj po insistojnë që ta miratojmë Planin rregullues, për shkak se ka rrezik me i humbur fondet që janë të parapara.

Genc Bashota dha sqarime, duke thënë se ajo i ka kaluar të gjitha procedurat edhe në diskutim publike dhe ka ardhur në fazën e aprovimit me një ndryshim që ka dalë prej diskutimit publik. **Agim Kuleta, kryesues**, tha se sqarimet tjera do t'i kemi në Kuvend, do të thotë është propozim që të futet në rend dite për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;

2. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2021 (TM20);
3. Informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimit gjatë pandemisë për vitin shkollor 2020 -2021;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për Qytetin e gjelbër (BERZH);
5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020;
6. Plani i veprimit i menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020;
7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt. 16.06.2021;
8. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit komunal 2021-2029 Prishtinë;
9. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2021 (TM20).

Agim Kuleta, kryesues, tha se diskutojmë në mbledhje të Kuvendit.

Valbona Makolli dha sqarime. Ajo tha se më 30 të muajit të kaluar ka qenë afati i fundit. Raporti është publikuar sipas rregullave ligjore, mirëpo nëse ka ndonjë ndryshim ose diçka tjetër, ne mund ta riformulojmë.

Agim Gashi theksoi se në informatën e arsimit ishin një varg donacionesh që ishin zbatuar në fushën e arsimit, ndërsa në Raportin finansiar më duket se nuk ishin përfshirë të gjitha ato donacione.

Ju kisha propozuar ta kontrolloni Raportin nëse nuk janë përfshirë, dhe krahasoje me informatën e arsimit. Nëse ju ka shpëtuar diçka është mirë ta përfshini.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 pill - 30 qershor 2021 (TM20) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimit gjatë pandemisë për vitin shkollor 2020 -2021.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimit gjatë pandemisë për vitin shkollor 2020 - 2021 dhe dërgohet në Kuvend.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për Qytetin e gjelbër (BERZH).

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për Qytetin e gjelbër (BERZH) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Plani i veprimit i menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Plani i veprimit i menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt. 16.06.2021.

Genc Bashota dha sqarime, duke thënë se në qershor kemi bërë ndryshim, sepse e kemi një numër të kompanive, prej vitit 2013 është rregullorja që ne i taksojmë në bazë të tarifave të mundshme. Disa prej tyre kanë paguar rregullisht e disa prej nuk kanë paguar zakonisht pa shkuar me ia kërkuar të hollat, kemi pasur vërejtje nga auditori dhe kemi qenë të detyruar që ndryshimi i vitit 2013, Rregullorja i ka pasur disa kode, në bazë të të cilave ne identifikojmë kompanitë të cilat kanë ndryshuar në 2014 e tutje me kode të veprimtarive dhe ne atë ditë i harmonizuam, mirëpo na ka dalë një telashe, d.m.th. krejt janë në rregull, përveç dy prej tyre,

Telekomi dhe bankat me kode të reja. P.sh. bankat i kanë shti edhe këmbimoret në atë kod, ne kemi qenë të obliguar mos me i ndryshuar kodet edhe te Telekomi. Rregullorja thotë se duhet me planifikua Telekomin, ne ia kemi qitur çmimin 1000 euro në vitin 2013, tani kanë hyrë edhe Radiotelevizionet, mobishopet dhe të njëjtin kod e kanë. Unë vetëm kam kërkuar që me u fiksuar këta dy zëra si kanë qenë 2013, te kodet nuk mund t'i ndryshojë, por e keni në arsyetim, e kemi thënë Telekomi i ka edhe bankat.

Vala Peshku tha se jemi duke folur për përputhshmëri të kodeve të veprimtarive.

Genc Bashota u shpreh se përputhshmëria e vitit 2013 me tash, nëse kthehet në atë si kod nuk korrespondon.

Ne po kërkojmë tani në kuadër të këtyre dy zërave, dy emrave të kodeve, me u fiksuar tamam në përbajtje, për arsy se po kemi telashe prej njerëzve e po më duket eshtë e drejtë e tyre.

Agim Kuleta, kryesues, tha se a nuk mundemi me votuar në njëfarë mënyrë bllok, por tash brenda saj janë disa pozicione që duhet me i ndryshuar.

Genc Bashota dha sqarime për këtë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt. 16.06.2021 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit komunal 2021-2029, Prishtinë.

Genc Bashota dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se për këtë Plan kanë punuar tri vite, që nga viti 2018, dhe kanë pasur shumë takime me grupe punuese, mbi 50 takime vetëm të incizuara. Ky dokument i ka tre kapituj: profili i qytetit, vlerësimi i gjendjes dhe vizioni. Ajo që nuk shihet këtu eshtë një data-bazë tepër e fuqishme, data baza e të gjitha incizimeve gjeodezike në qytet, duke përfshirë rrjetet e ngrohjes, të ujësjellësit dhe të kanalizimi. Këto nuk i ka pasur Prishtina në Planin rregullues asnjëherë, një data-bazë, që unë them se ka me i shërbyer secilit ekzekutiv që do të vije në të ardhmen, sidomos këtyre që punojnë në Komunë.

Kjo që po kërkojmë ne, që e kemi qitur në rend dite, nuk eshtë miratim, por shqyrtimi publik 30 ditë në Planin zhvillimor komunal, që do të jetë i hapur për publikun, për ekspertë dhe për të gjithë, dhe i njëjtë do të prezantohet në Kuvend.

Florim Krasniqi ceku se gjatë 30 ditëve jemi duke u munduar t'i mbajmë së paku pesë prezantime në zonat rurale dhe zonë urbane, pastaj ky dokument ka me qenë i publikuar i prezantuar fizikisht në ballinë e Komunës së Prishtinës, ku gjatë gjithë kohës, gjatë gjithë javës tetë orë, një ditë ka me qenë një ekip mobil, i cili do të japë sqarime profesionale për të gjitha grupet e interesit lidhur me këtë plan.

Agim Gashi parashtroi dy pyetje. E para, a ka me pasur afat të mjaftueshmë ligjor që kjo përbërje e Kuvendit me miratuar, po paragjykoj.

Genc Bashota shprehu mendimin se ligjërisht po.

Agim Gashi bëri të ditur se para disa ditësh ka lexuar se në vitin e ardhshëm Qeveria e Kosovës do të realizojë regjistrimin e popullsisë. A do të kishte qenë më mirë me i pritur rezultatet

statistikore të regjistrimit të fundit, për me i shfrytëzuar statistikat më të reja të mundshme të cilat do të ndikoni në saktësinë e planifikimit të këtij dokumenti bazik për Komunën e Prishtinës.

Po ashtu, pyeti me grupet e interesit a është përfshirë Forca e Sigurisë së Kosovës, pasi që qyteti ka një territor bukur të madh dhe mendoj që ka ardhur koha në planifikime të tilla duhet të marrinë pjesë edhe interesat ushtarake të Kosovës.

Genc Bashota tha se sipas statistikave 198 mijë banorë. Edhe pa u bërë një regjistrim i tillë ne dimë se ka më shumë banorë në komunëm e Prishtinës. Në dokument mundeni me i gjetur vlerësimet që janë bërë edhe prej Bankës Botërore, edhe prej të tjera sa i përket çështjes së popullsisë në kryeqytet, d.m.th. sa janë vlerësime, jo shënime statistikore të cilat janë zyrtare, orët e rrymës nëse nuk gaboj. orët e rrymës aktive kanë dal rrëth 136 mijë, është e pamundshme, në Prishtinë ka dalë një numër i madh i orëve aktive.

Sa i përket pyetjes për FSK-në, ne kemi pasur takime me gjithë akterët, tash për FSK nuk jam i saktë.

Florim Krasniqi tha se ne në nivelin qendror në kuadër të këtyre pesë takimeve kemi takuar edhe disa grupe të cilat janë me rëndësi të veçantë.

Blerand Stavileci parashtroi pyetje, duke thënë se këtu te popullsia e kemi një të dhënë zyrtare të regjistrimit, si Prishtina p.sh. orët e rrymës, por ka edhe kritere të tjera në bazë të cilave, a ka edhe diçka mbi të cilën, se nuk mundesh me dhënë të dhënë paralele, por të paktën në bazë të krahasimeve logjike me thënë në bazë të kësaj, kësaj popullsia e Prishtinës është kjo.

Florim Krasniqi tha sqarime.

Vala Peshku shtroi pyetjen se nëse është punuar tri vjet, por nuk e kam të qartë qeverisë së ardhshme, por a nuk është pak e padrejtë për qeverisjet e ardhshme që vinë nëse na iu lëmë një plan 8-vjeçar, dhe pyetja tjetër se a ndërlidhet ky plan me Hartën zonale.

Genc Bashota u shpreh se nuk mundesh me bërë Hartën zonale pa e bërë planin për banorë, përgjigjja ime është se ne nuk jemi duke miratuar, ky është për diskutim publik.

Vala Peshku tha se një gjë e tillë është bërë edhe në vitin 2013, pak para se me përfunduar LDK-ja mandatin. Unë kom problem në parim me këtë gjë, se po më duket se nuk është aspak logjike me pru një plan për 8 vjetët e ardhshme, përderisa ne si legjislacion, asamblistë e ju ekzekutiv jemi në përfundim të mandatit, se me këtë plan 8-vjeçar Qeverisë së ardhshme në Prishtinë ose ia lejojmë me thënë ose s'mundem me bërë gjë prej premtimeve, ose ia mohojmë me bërë një plan. Po ashtu, pyeti se a ka ardhur miratimi prej Ministrisë së Mjedisit Hapësinor.

Genc Bashota bëri të ditur se para 20 ditëve e ka dërguar në Ministrin e Mjedisit Hapësinor dhe jemi duke e pritur miratimin prej Ministrisë.

Vala Peshku u shpreh se, do me thënë pa se me marrë miratimin prej Ministrisë ne pe qesim në Kuvend.

Genc Bashota tha mundemi me qitura në Kuvend, a në diskutim publik jo pa e marrë miratimin prej Ministrisë.

Halim Halimi tha se prej vitit 2013 është dashur të bëhet Harta zonale edhe nuk po mundeni me bërë atë Hartë zonale! Është mirë që është bërë një Plan zhvillimor komunal, dokument themeltare i planifikimit hapësinore në bazë të Ligjit të planifikimit hapësinor. Ne jemi në kohë

pandemie, çdo ditë po rritet numri, andaj pse me u ngutur me e qitë në diskutim publike në valën e pandemisë, pra është mirë me shtyrë për një kohë.

Genc Bashota tha se në pandemi po punojmë, nuk e di çka është problemi me ardhur në diskutim publik.

Halim Halimi theksoi se ka problem, qysh janë mbajtur deri tani diskutimet si për buxhet, i kemi incizimet, por i ke vetëm me nga 3-4 vetë që kanë interes personal.

Fadil Gashi uroi që të jetë punuar mirë ky Plan, e pse po nguten, le të kryejnë punë, nëse këta ekspert kanë punuar në atë Plan zhvillimor siç duhet, ne nuk jemi ekspertë.

Genc Sherifi u shpreh se ne jemi Kuvend dhe i plotfuqishëm dhe mundemi me votuar çka duam, deri në momentin që certifikohen zgjedhjet tjera.

Ky dokument po del në diskutim publik, nuk po themi se ky dokument është as i mirë, as i keq, le të vlerësohet nga publiku, nëse është ky dokument i keq unë nuk e votoj.

Blerand Stavileci shprehu mendimin se krejt problemi është i natyrës politike dhe aspak i natyrës profesionale. Pra, problemi është i natyrës politike dhe këtu janë dy aspekte, që gati janë të pakapërcyeshme në aspektin politik, e që lehtësisht janë të kapërcyeshme në aspektin profesional, se profesionali na thotë a është i mirë, a i keq, a është i pastër, a i varfër si Plan. Në atë politik i ka dy aspekte, e ka atë parimor dhe atë kohor.

Si ide po jap për me shpëtuar punën e profesionistëve, ndoshta kishte qenë mirë me bërë në një mënyrë që edhe këta që kanë punuar me marrë një lloj merite, por edhe ata që kanë me ardhur mos me i penguar. Ndoshta planin që e bëjnë të tjerët ka me qenë më i mirë në aspektin profesional, por ne e dimë edhe sot çka po ndodh, në politikë shumë gjëra nuk po na pëlqejnë por janë votuar, shumë gjëra në të kaluarën kanë qenë më mirë por janë votuar. Pra gjykimi është politik, kjo është politika, edhe ne këtu jemi politik, nuk jemi profesional. Unë e kam problemin parimor dhe kohor të anakronisë.

Jeta Rafuna tha se vet fakti që është ardhur në seancën e fundit, por ndoshta seancën e fundit kemi me mbajtur në shtator dhe po duan me na imponuar me votuar një Plan zhvillimor që nuk dihet se tash kush vjen kryetar dhe në njëfarë forme me ia obliguar atë Plan me punuar kryetari i ardhshëm, e unë jam kundër.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit komunal 2021-2029, Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Agim Kuleta, kryesues, tha se në Kuvend i propozoni si GP.

Sami Boroci tha se a duhet ligjërisht me bërë komision të ri, a çka është puna, me bërë një komision në fund të mandatit, që d.m.th. me asamblistë që veç s' kanë me qenë më, e dimë që përbëhet edhe prej njerëzve të tjerë jo vetëm të këshilltareve komunalë, andaj unë nuk po e shohë të arsyeshme. Unë në këtë pikë jam kundër dhe kisha rekomanduar që këtë pikë me lënë për seancat e përbërjes së re.

Vala Peshku u shpreh se caktimi i komisionit në fund të mandati, para fushatës zgjedhore, formohet për të fituar vota, andaj nuk e votojmë këtë komision.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se ideja ka qenë qysh ka ardhur deri te formimi, ideja në kuvend ka qenë, jemi pajtuar të gjithë, sepse në çdo mbledhje kemi pasur propozime për emërtimë të rrugëve dhe kemi thënë të bëjmë një grup punues që i mbledh propozimet e asamblistëve dhe e mbajmë një mbledhje, ku si grup punues i propozojmë Kuvendit dhe i votojmë bllok. E kemi mbajtur një mbledhje të grupit dhe kemi kërkuar me e-mail. Kam kërkuar me i dërguar emrat prej pjesëmarrësve, nuk ka pasur përgjigje, në ndërkohë më kanë ardhur shumë propozime, unë çdo herë kam insistuar që me formuar grup punues, se nuk ke nevojë me zgjatur procedura, por vetëm i kishim mbledhur propozimet çka i kishim pasur, në një mbledhje e kishim përpiluar listën dhe në Kuvend i kishim votuar, ishte kryer, e tani komisioni është procedurë më e gjatë.

Sami Boroci theksoi se po e shoh të pakuptimitë në këtë fazë me formuar një komision, ndoshta më herët ka qenë më mirë, kishte mundur me bërë punë.

Agim Gashi theksoi le të shkojë në Kuvend, e në Kuvend vendoset që të miratohet apo të mos miratohet.

Vala Peshku tha të gjitha rrugët i kisha bërë me numra, më parë i kisha bërë me numra sës 100% me emra të meshkujve.

Agim Kuleta, kryesues, bëri të ditur se kur është miratuar ligji në Kuvend të Kosovës, është propozuar që të ketë rrugë, blloqe etj.

Leutrim Retkoceri theksoi se para tri vjetëve kemi kërkuar që të kemi diçka zyrtare në këtë aspekt, tash si kanë vazhduar dhe çka është kërkuar, ka qenë gjithmonë dy qëndrime, ose me u bërë grup punues, ose me u bërë komision. Komisioni është i pérhershëm, komisionet që formohen për emërtimin e rrugëve është kompetencë e Kuvendit komunal, që i emëron ata, mirëpo këto komisione e kanë edhe një afat ligjor 5-vjeçar. Komisioni i kaluar tash për tash është pa mandat.

Në komision, ashtu si e parashev ligji, duhet të jetë dikush nga Instituti i Historisë, nga Muzeu i Kosovës, duhet me pasur ekspertë të fushave të ndryshme, dreitorive të ndryshme, pastaj komisioni kthehet në votim, kryhet një çështje në bazë institucionale.

Sami Boroci theksoi se më korrekte është me lënë tani në fillim të mandatit të ardhshëm, kushdo që zgjidhet prej nesh asamblist i ri, është imediate me propozuar dhe me formuar një komision të ri, funksionon shumë më mirë.

Agim Kuleta, kryesues, tha se propozimi prej Kuvendit ka ardhur dhe duhet me përcjellë në Kuvend për votim ose jo.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dhjetë
Të ndryshme**

Linda Spahiu nga Kabineti i kryetarit, propozoi që të futet edhe një pikë e rendit të ditës për Kuvend. Fjala është për Vendimin e miratuar në muajin maj, për caktim lokacioni për vendosjen e obeliskut për profesionistët shëndetësorë që kanë humbur jetën dhe kanë kontribuar në vijë. Lokacioni është në QKUK, te garazhi, d.m.th. është pronësia e Komunës, dhe që të shihet më mirë, me qenë si pikë referimi ky obelisk, monument, të zhvendoset për 10-15 metra, kjo është për shkak të sigurisë në komunikacion, se nëse vendoset aty ku është miratuar ju paraqet pak rrezik.

Agim Gashi tha vetëm silleni Propozimvendimin, ne e votojmë.


Agim Kuleta, kryesues, tha e dorëzoni propozimin dhe me pa skicën, pastaj e dërgoni në Kuvend, aty e propozon Osmani dhe e fusim në rend dite në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësja
Shyharete Islami

Kryesuesi i Komitetit

Agim Kuleta



Faqe 8 nga 8